



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PROKURIMEVE PUBLIKE

Elbasan më ____, ____, 2024

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMINE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

PROÇES-VERBAL PËR HARTIMIN E KRITEREVE

OBJEKTI I PROKURIMIT: "Rikonstruksioni në objekte arsimore" me fond limit 24,003,586
(njëzet e katërmilion e tre mijë e pesëqind e tetëdhjetë e gjashtë) **lekë pa t.v.sh.**

- **KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Kodi CPV: 45214200-2 - Punime ndërtimi për shkolla**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", autoriteti/enti kontraktor, Bashkia Elbasan, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1. KRITERET E PËRGGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimi nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Kriteret e përgjithshme përmbajnë listën e dokumentacionit, ligjor dhe administrativ, të kandidatëve/ofertuesve, që duhet të plotësojnë për të marrë pjesë në procesin e prokurimit, në përputhje me nenin 76 dhe 77 të LPP-së, nr.162 datë 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”.

Kriteret e përgjithshme për pranimin e operatorëve pjesëmarrës janë të pandryshueshme dhe janë vënë të njëjta me Dokumentet Standarde të Tenderit sipas Vendimit Nr. 02 Datë 09.06.2021 të miratuara nga APP.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Kriteri (1- a) është vendosur në bazë të nenit 83 të LPP dhe nenit 30 pika 1 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Kriteri (1-b) bazohet në nenet 76, 77 dhe 82 të LPP si dhe nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë:

Sipas Shtojcës 7.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Vendosija e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilanci vjetore, për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në përputhje me Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur referuar nenit 43, pika 4 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe bazuar në Nenin 77 pika 3, e LPP nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c. Vendosija e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të ketë paguar **taksat dhe tarifat vendore për vitin 2024 (këstet e maturuara)** për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB), sipas afateve të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

Gjithashtu një deklaratë nga administratori i shoqërisë mbi kontratat publike dhe private me të cilat është angazhuar shoqëria gjatë vitit 2024 sipas formatit të mëposhtem:

Nr	Emertimi i kontrates	Vendi i zbatimit te kontrates (Bashkia)
1		
2		

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetim për taksat dhe tarifave vendore).

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 76, pika 2 të LPP si dhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c. Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar që operatorët ekonomikë nuk kanë pagesa të pashlyera të taksave dhe tarifave vendore.

2.3 Kapaciteti teknik

2.3.1 Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:

a- punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

-Për të vërtetuar përvojen e mëparshme duhet të paraqiten:

-Nëse kontrata është realizuar me institucione shtetërore: Formulari i vlerësimit (sipas shtojcës 9) i shoqëruar me: -Kontratë punimesh; -Situacion përfundimtar; -Akt-kolaudimi; -Procesverbal për marrje në dorëzim të punimeve të kryera.

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontraten e bashkimit të operatorëve ekonomikë si dhe preventivin e ndarjes së punimeve të marra përsipër nga secili operator ekonomik të deklaruar në fazën e tenderimit.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

-Nëse kontrata është realizuar me subjekte private: Formulari i vlerësimit i shoqëruar me: - Kontratë punimesh, -Situacionin përfundimtar, -Akt-kolaudimin, -Çertifikatën e marrjes në dorëzim, -Faturat tatimore për çdo situacion punimesh.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Investitorit.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura për përvojën e suksesshme e bën ofertën të kualifikueshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo me te vogel se dyfishi i vlerës limit të objektit të prokurimit për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Liçensa profesionale e shoqërise për realizimin e punimeve, objekt i kontratës:

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI:

- **NP-1 A** Punime gjurmimi në tokë
- **NP-2 A** Ndertime civile dhe industriale
- **NP-3 A** Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada
- **NP-7 A** Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI:

- **N.S - 1 A** Punime për prishjen e ndërtimeve
- **N.S- 2 A** Impiante hidrosanitare kuzhina, lavanteri dhe mirembajtja e tyre
- **N.S - 4 A** Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtues

- Sipas modelit të leshuar nga institucioni përgjegjës për dhenien e licensave profesionale sipas legjisllacionit në fuqi.

-Për Operatorët e huaj të bëhet njësimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësimin të licensave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar me VKM nr 92 .DT 19.02.2014 ku janë të përcaktuara kategoritë përkatëse dhe niveli i klasifikimit për licensat e subjekteve që ushtrojnë veprimtari në fushën e ndërtimit.

Kategoritë e licensave janë përcaktuara në bazë të zerave të përkrahura në preventivin e projektit.

Niveli i Shoqërisë sipas vlerave në lekë të punimeve të kryera për çdo kategori punimi.

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1	Punime gjurmimi në tokë.	Punimet e gjurmimit të dheut sipas preventivit: Gjurmim dheu themele e plinta me b-2m, ekskavator me zinxhir 0.25m ³ , shkarkimi në auto	A	0-20 milion
NP-2	Ndertime civile e industriale	Punime themeli, kollona b/a monolite, mur betoni, mur me blloqe betoni, fv hekur betoni etj sipas preventivit: Themel e xokol butobetoni C16/20; Breza b/a monolit C 16/20; Kollona b/a monolite C 16/20 h ~ 4m; Mur betoni C 20/25 etj.	A	0-20 milion
NP-3	Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash	Punimet për rikonstruksionin e objekteve arsimore sipas preventivit	A	0-20 milion
NP-7	Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje	Punimet për ujësjellës e kanalizim të jashtëm sipas preventivit: F.V tuba betoni Ø 200 mm; F.V tuba betoni Ø 300 mm; Pusete shkarkimi 80 x 80, h = 200 cm; Pusete shiu 40 x 40, h = 100 cm, me kapak gize	A	0-20 milion
NS-1	Punime për prishjen e ndertimeve	Punimet e prishjes sipas preventivit: Prishje shtresa betoni; Prishje mur tulle pa pastrim; Prishje mure betoni; Prishje mur blloqe betoni etj.	A	0-20 milion
NS-2	Impiante hidro-sanitare dhe mirembajtja e tyre	Punime për instalimet Hidro-Sanitare sipas preventivit	A	0-20 milion
NS-4	Punime rifiniture të muratave dhe të lidhura me to, rifinitura me material druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndertuese	Punimet sipas preventivit: Suvatime, lysterje, dyer dritare etj	A	0-20 milion

2.3.3 Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administrator i shoqërisë), Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçensën dhe listpagesat e shoqërisë, dhe për të cilin duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Kontratë pune noteriale
- b) Diplomë

(Ne rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçensën dhe listpagesat e shoqërisë.)

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues për drejtuesin teknik, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Ky kriter bazohet në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe në UKM nr. 2, datë 13.05.2005, Kreu I, pika 2. “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

2.3.4 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të cilët duhet të figurojnë në licencën si dhe listëpagesat e shoqërisë për 3 (tre) muajt e fundit, si mëposhtë:

- 1 (nje) inxhinier ndertimi
- 1 (nje) inxhinier hidroteknik

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës noteriale e vlefshme dhe diploma.

Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kriterëve të VKM nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar, sa i takon ndalimeve të dypunësimit. Për këto arsye të paraqitet deklaratë perkatëse nga Administratori i shoqërisë.

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues që OE i disponon punonjesit e mesipërm do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe ne Vendimin e Keshillit të Ministrave nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi”, i ndryshuar me VKM nr. 92, date 19.02.2014 ku janë të percaktuar kategoritë perkatese për licensat e subjekteve që ushtrojnë veprimtari në fushën e ndertimit. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Punimet apo veprimtaritë konkrete, të cilat lidhen edhe me kategoritë e licensave, për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale:

<i>1 (nje) Inxhinier Ndërtimi</i>	<i>Është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar preventivit të punimeve (Punime ndertimi, Germimi, Prishje), të cilave i korrespondojnë kategoritë NP-1, NP-2, NP-3, NS-1, NS-4.</i>
<i>1 (nje) Inxhinier Hidroteknik</i>	<i>Është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve hidrosanitare, ujësjelles e kanalizime, të cilave i korrespondon kategoria NP-7, NS-2.</i>

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të kualifikuar, si mëposhtë:

- 2 (dy) punonjës teknik ndertimi
- 1 (nje) punonjës teknik topograf
- 2 (dy) punonjës hidroizolues
- 2 (dy) punonjës bojaxhinj
- 2 (nje) punonjës suvatus
- 1 (nje) punonjës murator
- 2 (dy) punonjës pllakashtrues
- 2 (dy) punonjës hidraulike
- 2 (dy) punonjës betonues
- 2 (dy) punonjës karpentier
- 1 (nje) punonjës hekurkthyes
- 2 (dy) punonjës duro alumini
- 1 (nje) punonjës saldator
- 1 (nje) punonjës manovrator eskavatorist
- 1 (nje) punonjës manovrator automakinist
- 2 (dy) punonjës shofere
- 8 (tetë) punonjës të thjeshtë/ndihmes

- Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit.
- Për punonjësit e kualifikuar të ndërtimit të paraqitet Çertifikatat/diplomat/dëshmia të leshuara nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.SH “I ndryshuar.
- Për teknikun e ndërtimit dhe teknikun topograf do të pranohet vetëm diploma e shkollës së mesme/licence profesionale nga institucionet përkatëse.
- ***Nuk do të njihen si dëshmi profesionale kurset e trajnimit të lëshuara nga subjektet të cilat nuk janë të licensuara/akredituara nga institucionet përkatëse për licensimin/akreditimin e tyre.***
- Ndersa për punonjësit shofere dhe manovratorë të mjeteve të rënda duhet të paraqiten dëshmi të aftësisë profesionale / leje drejtimi dhe certifikate të aftësisë profesionale sipas rastit, të lëshuara nga D.P.SH.T Rrugore.
- **Në rast se operatori ekonomik, i disponon mjetet e rënda në pronësi, duhet të ketë operatorët e mjeteve në listëpagesë për tre muajt e fundit.**
- **Për mjetet e rënda të cilat janë të marra me qera, OE duhet të paraqesë për manovratorin/makinistin,** kontratën e punës së vlefshme, dëshminë e drejtimit të vlefshme, lëshuar nga institucionet përkatëse, dëshmitë e drejtimit të lëshuara nga D.P.SH.T Rrugore, por pa qenë e nevojshme që këta manovratorë të figurojnë në listëpagesën e OE për periudhën e kërkuar.

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues që OE i disponon punonjësit e mësipërm do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimit.

Argumentimi: vendosja e këtij kriteri bazohet në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për punonjësit e kualifikuar lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve, duke krijuar besueshmërinë se kanë përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Në përcaktimin e profileve konkrete të stafit teknik punonjësve të kualifikuar, si dhe numrit të tyre, AK është bazuar në manualin e çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”, VKM nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP), të rishikuar, Urdhër nr.200, datë 16.05.2019 të Ministrisë të Infrastruktura dhe Energjitikës “Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit“, Ligjin Nr. 7961, datë 12.7.1995 “KODI I PUNËS I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË“, i ndryshuar, zërat e punimeve të preventivit, volumet për keto zera dhe të grafikut të punimeve.

- **Tekniku i ndërtimit** është i nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit, sipas zërave të preventivit të punimeve, sic janë germimet, punimet e shtresave, punimet e betonit, punimet e muratës etj, lexon dhe kontrollon zbatimin e projektit në përputhje me kushtet

teknike të zbatimit (KTZ), implementon kërkesat dhe direktivat e inxhinierit dhe ndan detyrat për punetoret dhe ndjek ecurinë e tyre gjatë kohës së punës. Duke qenë se janë 18 objekte arsimore të shpërndara në territorin e Bashkisë Elbasan, qytet dhe fshat, në të cilat do të nderhyet dhe sipas grafikut të punimeve do të punohet paralelisht në disa objekte çdo muaj është kërkuar që OE të kenë 2 të tilla.

- **Tekniku topograf** është i nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit, për zbatimin e saktë të kuotave të projektit në ndërtimet e reja që do të kryhen duke asistuar drejtuesin teknik. Punimet ku kërkohej prezenca e teknikut topograf janë punimet e themeleve, ndërtimi i mureve të betonit, punimet për ujesjelles kanalizimet e jashtme.
- **Hidrauliku** është i nevojshëm për realizimin e punimeve hidraulike, sipas zërave të preventivit të punimeve. Numri i kërkuar është bazuar në grafikun e punimeve, ku këto punime janë parashikuar të realizohen në muajt e dytë dhe të tretë, dhe ku volumi më i madh i punimeve hidraulike është parashikuar të realizohet në muajin e tretë, si dhe tek perlllogaritjet e bera bazuar në manualin e çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” për kohën e punës që duhet për të realizuar çdo zë të punimeve të parashikuara në preventiv. Kështu sipas manualit orët e punës për të perfunduar punimet hidraulike të parashikuara për tu realizuar në muajin e tretë janë 946 ore, që të kthyer në ditë pune janë 118 ditë pune ($946/8=118$). Duke llogaritur që këto punime duhet të perfundojnë në një muaj del që nr. i punonjësve duhet të jetë rreth 5 persona. ($118/22=5.3$). Pra janë llogaritur minimumi dy punonjës të kualifikuar hidraulike dhe tre punonjës të thjeshtë/ndihmes. Llogaritja e kohës ditore dhe javore të punës janë bërë bazuar në percaktimet e kodit të punës. (koha ditore e punës 8 ore dhe ajo javore 40 ore, gjithsej 22 ditë pune në muaj).
- **Karpentierët** janë të nevojshëm për punimet beton arme, punime themeli, kollona e soleta sipas zerave të preventivit. Bëjnë piketimin dhe armaturen anësore të themelit, bëjnë vendosjen e modinave për kolonat dhe muret e betonit, ndërtojnë armaturen, kallepet e kolonave, mureve, montojnë skelerinë përforcuese për fazën e betonimit të mureve dhe kolonave, prerjen dhe montimin e strukturave prej druri e metali si dhe ndërtimin e kornizave dhe strukturave të tjera përforcuese prej druri, bashkimin dhe montimin e elementëve metalik apo materiale të tjera, të nevojshme për realizimin e objektit që do të ndërtohet. Numri i kërkuar është bazuar në grafikun e punimeve, ku të gjitha punimet ku kërkohej prezenca e punonjësve karpentierë është parashikuar të realizohet në muajin e parë, të tretë, të katërt dhe të pestë si dhe tek perlllogaritjet e bera bazuar në manualin e çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” për kohën e punës që duhet për të realizuar çdo zë të punimeve të parashikuara në preventiv.
- **Hekurkthyesi** është i nevojshëm për përzgjedhjen, prerjen, kthimin dhe vendosjen e hekurit, për realizimin e zërave të punimeve të hekur betonit sipas preventivit.
- **Hidroizoluesit** janë të nevojshëm për punimet e hidroizolimit sipas zerave të preventivit. Numri i kërkuar është bazuar në grafikun e punimeve, ku këto punime janë parashikuar të realizohen në muajt e parë, të dytë, të tretë dhe të pestë, dhe ku volumi më i madh i punimeve hidraulike është parashikuar të realizohet në muajin e pestë, si dhe tek perlllogaritjet e bera bazuar në manualin e çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin

e sistemit te integruar per informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” per kohen e punes qe duhet per te realizuar cdo ze te punimeve te parashikuara ne preventiv. Keshtu sipas manualit oret e punes per te perfunduar punimet e hidroizolimit te parashikuara per tu realizuar ne muajin e peste jane 443 ore, qe te kthyer ne dite pune jane rreth 55 dite pune ($443/8=55.3$). Duke llogaritur qe keto punime sipas grafikut jane parashikuar te perfundojne ne 22 dite del qe nr. i punonjesve duhet te jete rreth 3 persona. ($55/22=2.5$). Pra jane llogaritur minimumi dy punonjes te kualifikuar dhe 1 punonjes ndihmes. Llogaritja e kohes ditore dhe javore te punes jane bere bazuar ne percaktimet e kodit te punes. (koha ditore e punes 8 ore dhe ajo javore 40 ore, gjithsej 22 dite pune ne muaj).

- **Betonuesi** është i nevojshëm për realizimin e punimeve te betonit sipa zerave te preventivit. Ndhomon në ndërtimin e armaturës brenda së cilës do derdhet betoni, vendosin shtyllat mbajtëse të peshës, morsetat dhe mjetet e tjera që sigurojnë qëndrueshmërinë e armaturës ndaj peshës dhe presionit të ngarkesës beton, Shpërndajnë betonin dhe e shtrojnë atë në soleta, kolona, shkallë, mure, ballkone, ura, apo strukturave të tjera në kohën e duhur, sipas radhës së përcaktuar nga projekti dhe drejtuesi teknik i objektit, bëjnë vibrimin e betonit gjatë çdo betonimi, kryejnë nivelimin e betonit, kryejnë lustrimin e betonit apo çimentos. Numri i kerkuar eshte bazuar te grafiku i punimeve, ku te gjitha punimet ku kerkohet prezenca e punonjesve betonues eshte parashikuar te realizohet ne muajin muajin e pare, te trete, te katert dhe te peste, si dhe tek perlllogaritjet e bera bazuar ne manualin e çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.216, date 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit te integruar per informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” per kohen e punes qe duhet per te realizuar cdo ze te punimeve te parashikuara ne preventiv. Keshtu sipas manualit oret e punes per te perfunduar punimet e betonit te parashikuara per tu realizuar ne muajin e peste jane 893 ore, qe te kthyer ne dite pune jane rreth 111 dite pune ($893/8=111.6$). Duke llogaritur qe keto punime sipas grafikut jane parashikuar te perfundojne ne 22 dite del qe nr. i punonjesve duhet te jete rreth 5 persona. ($111/22=5$). Pra jane llogaritur minimumi dy punonjes te kualifikuar betonues, 2 karpentier dhe 1 punonjes ndihmes. Llogaritja e kohes ditore dhe javore te punes jane bere bazuar ne percaktimet e kodit te punes. (koha ditore e punes 8 ore dhe ajo javore 40 ore, gjithsej 22 dite pune ne muaj).
- **Pllaka shtruesi** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të shtrimit te pllakave dhe parketit sipas zërave të preventivit të punimeve. Përgatitin sipërfaqen e dyshemesë për t’u mbuluar me parket, pllaka ose materiale të tjera; Përgatitin materialet e nevojshme për shtrimin e pllakave; Bëjnë matjen dhe prerjen e pllakave sipas projekti; Vendosin pllakat apo materialet e tjera në dysheme; Montojnë pjesët e parketit etj. Numri i kerkuar eshte bazuar te grafiku i punimeve, ku te gjitha punimet ku kerkohet prezenca e punonjesve pllaka shtrues eshte parashikuar te realizohet ne muajt e dyte, te trete dhe te katert, si dhe tek perlllogaritjet e bera bazuar ne manualin e çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.216, date 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit te integruar per informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” per kohen e punes qe duhet per te realizuar cdo ze te punimeve te parashikuara ne preventiv. Duke qene se prezenca me e madhe kerkohet ne muajin e katert ateherë, duke ju referuar menyres se perlllogaritjes se mesipercituar rezulton se sipas manualit oret e punes per te perfunduar punimet e per shtrimin e pllakave te mermerit te parashikuara per tu realizuar ne muajin e katert jane rreth 2924 ore, qe te kthyer ne dite pune jane rreth 365 dite pune ($2924/8=365.5$). Duke llogaritur qe sipas grafikut jane parashikuar te perfundojne ne 22 dite del

qe nr. i punonjesve duhet te jete rreth 16 persona. ($365/22=16.5$). Pra jane llogaritur minimumi dy punonjes te kualifikuar. Llogaritja e kohes ditore dhe javore te punes jane bere bazuar ne percaktimet e kodit te punes. (koha ditore e punes 8 ore dhe ajo javore 40 ore, gjithsej 22 dite pune ne muaj).

- **Suvatuesi** është i nevojshëm për realizimin e punimeve te suvatimit sipas zërave të preventivit. Kryejne vendosjen e një ose më shumë shtresave të suvasë në muret e brendshme dhe në tavanet e godinave duke realizuar një sipërfaqe të lëmuar. Numri i kerkuar eshte bazuar te grafiku i punimeve, ku te gjitha punimet ku kerkohet prezenca e punonjesve suvatues eshte parashikuar te realizohet ne muajt e pare, te dyte, te trete dhe te katert, si dhe tek perlllogaritjet e bera bazuar ne manualin e çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.216, date 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit te integruar per informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” per kohen e punes qe duhet per te realizuar cdo ze te punimeve te parashikuara ne preventiv. Duke qene se prezenca me e madhe kerkohet ne muajin e trete atehere, duke ju referuar menyres se perlllogaritjes se mesipercituar rezulton se sipas manualit oret e punes per te perfunduar punimet e per shtrimin e pllakave te mermerit te parashikuara per tu realizuar ne muajin e katert jane rreth 980 ore, qe te kthyer ne dite jane rreth 122 dite pune ($980/8=122.5$). Duke llogaritur qe sipas grafikut jane parashikuar te perfundojne ne 22 dite del qe nr. i punonjesve duhet te jete rreth 5 persona. ($122.5/22=5.5$). Pra jane llogaritur minimumi dy punonjes te kualifikuar. Llogaritja e kohes ditore dhe javore te punes jane bere bazuar ne percaktimet e kodit te punes. (koha ditore e punes 8 ore dhe ajo javore 40 ore, gjithsej 22 dite pune ne muaj).
- **Muratori** është i nevojshëm për realizimin e punimeve te muraturës sipas zërave të preventivit. Bëjnë piketimin e mureve të objektit, bëjnë përgatitjen e sasisë së nevojshme të llacit për procesin ditor të punës, bëjnë breza përforcues betoni në gjysmën e lartësisë së murit ose sipas specifikimit në projekt; kontrollojnë nëse muret janë të lidhur midis tyre horizontalisht dhe vertikalisht duke garantuar kështu qëndrueshmërinë e tyre, ndërtojnë soletat, vendosin arkitraret e dverve dhe dritareve, bëjnë mbushjen me llac të mureve në nivelin e fashove me dorë ose me pompë në varësi të materialit të përcaktuar nga drejtuesi teknik në objekt, përgatitin materialin e nevojshëm për tavane me gips apo për tavane të varura zbukurues duke bërë matjet dhe prerjet e duhura.
- **Bojaxhiu** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të lysterjes me boje sipas zërave të preventivit të punimeve. Kryen përgatitjen e sipërfaqeve të ndërtesave dhe strukturave të tjera për lysterje, kryen përgatitjen e materialeve që do të përdoren për lysterje, bejne stukime, zmerilime, pastrime, kryejnë lysterjen me astar të sipërfaqes për lidhjen e saj me bojën, kryejnë lysterjen përfundimtare të sipërfaqeve me ngjyrat e përgatitura, bëjnë lysterjen me materiale përkatëse dhe bojëra mbrojtëse të sipërfaqeve të drunjtja, të strukturave metalike, kornizave të hekurta të ndërtesave. Numri i kerkuar eshte bazuar te grafiku i punimeve, ku punimet ku kerkohet prezenca e punonjesve bojaxhinj eshte parashikuar te realizohet kryesisht ne muajt e trete, te katert dh et peste, si dhe tek perlllogaritjet e bera bazuar ne manualin e çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.216, date 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit te integruar per informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” per kohen e punes qe duhet per te realizuar cdo ze te punimeve te parashikuara ne preventiv. Duke qene se prezenca me e madhe kerkohet ne muajin e trete atehere, duke ju referuar menyres se

perllogaritjes se mesipercituar rezulton se sipas manualit oret e punes per te perfunduar punimet per lyerjen te parashikuara per tu realizuar ne muajin e trete jane rreth 273 ore, qe te kthyer ne dite jane rreth 34 dite pune ($273/8=34.1$). Duke llogaritur qe sipas grafikut jane parashikuar te perfundojne ne 22 dite del qe nr. i punonjesve duhet te jete 2 persona. ($122.5/22=5.5$). Pra jane llogaritur minimumi dy punonjes te kualifikuar. Llogaritja e kohes ditore dhe javore te punes jane bere bazuar ne percaktimet e kodit te punes. (koha ditore e punes 8 ore dhe ajo javore 40 ore, gjithsej 22 dite pune ne muaj).

- **Punonjesi duro-alumin** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të vendosjes se dyerve dhe dritareve d/alumini sipas zërave të preventivit të punimeve. Kryejnë matje në objektin ku do të bëjnë punime duro-alumini; Presin dhe përgatitin objekte (dyer, dritare etj.) për porosinë e marrë duke u mbështetur në përmasat e kasë; Presin dhe vendosin xhama në dritaret e gominave; Kryejnë punime të ndryshme të duro-aluminit në ndërtesa. Numri i kerkuar eshte bazuar te grafiku i punimeve, ku punimet ku kerkohet prezenca e punonjesve duro-alumin eshte parashikuar te realizohet kryesisht ne muajt e dyte, te trete dhe te peste, si dhe tek perllogaritjet e bera bazuar ne manualin e çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.216, date 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit te integruar per informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” per kohen e punes qe duhet per te realizuar cdo ze te punimeve te parashikuara ne preventiv. Duke qene se prezenca me e madhe kerkohet ne muajin e dyte atehere, duke ju referuar menyres se perllogaritjes se mesipercituar rezulton se sipas manualit oret e punes per te perfunduar punimet per lyerjen te parashikuara per tu realizuar ne muajin e trete jane rreth 352 ore, qe te kthyer ne dite jane 44 dite pune ($352/8=44$). Duke llogaritur qe sipas grafikut jane parashikuar te perfundojne ne 22 dite del qe nr. i punonjesve duhet te jete 2 persona. ($44/22=2$). Pra jane llogaritur dy punonjes te kualifikuar. Llogaritja e kohes ditore dhe javore te punes jane bere bazuar ne percaktimet e kodit te punes. (koha ditore e punes 8 ore dhe ajo javore 40 ore, gjithsej 22 dite pune ne muaj)
- **Saldatori** eshte i nevojshem per punimet e saldimit te konstruksioneve metalike te perbera sipas zërave të preventivit.
- **Shoferi** eshte i nevojshem për drejtimin e mjeteve si kamione, kamionçina. Numri i kerkuar eshte bazuar ne numrin e mjeteve qe duhen, volumet per transportin e dherave dhe materialeve te ndertimit te dala nga germimi dhe prishja, transportin e materialeve qe do te perdoren per realizimin e objektit. Keshtu sipas grafikut eshte parashikuar qe vetem transporti i materialeve te ndertimit dhe dherave duhet te perfundoje brenda 22 diteve dhe sipas volumeve jane llogaritur tre mjete me tonazh 10 ton, e rrjedhimisht duhen 3 shofere.
- **Manovratori eskavatorist** eshte i nevojshem per përdorimin e makinerive të renda te ndertimit si eskavator germimi dhe fadroma te te gjitha llojeve, te cilat jane kerkuar pasi ne preventiv jane parashikuar punime qe kerkojne perdorimin e ketyre makinerive. Ne nenin 8, germa a, të rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës percaktohet: Makineritë e rënda të ndërtimit dhe emërtimet bëhen sipas Dëshmimeve të Aftësive Profesionale (DAP), të cilat ndahen si më poshtë:

a)-eskavator gërmimi e ngarkimi dherash të të gjitha llojeve si dhe fadromat e të gjitha llojeve (me goma dhe me zinxhirë), manovratorëve u jepet dëshmi për **ESKAVATORIST**.

- **Manovratori automakinist** është i nevojshëm për përdorimin e makinerive të rënda të ndërtimit si autobetoniere, autovinca, autopompe betoni, të cilat janë kërkuar pasi në preventiv janë parashikuar punime që kërkojnë përdorimin e këtyre makinerive. Në nenin 8, germa c, të rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjitikës përcaktohet: Makineritë e rënda të ndërtimit dhe emërtimet bëhen sipas Dëshmive të Aftësive Profesionale (DAP), të cilat ndahen si më poshtë:

c)-Automjete për përdorim të veçantë (APV) sipas pikës “g”, të nenit 54, të Kodit Rrugor, makineri ndërtimi mbi bazë automjeti:-autovinça, autobetonierë, autopompa betoni, autobitumatriçe, autosonda, autotokmak, manovratorëve u jepet dëshmi për **AUTOMAKINIST**.

2.3.6 Një punësim mesatar për tre muajt e fundit i të paktën **35** (tridhjetë e pesë) personave të vërtetuar me:

- a) Vërtetim të lëshuar nga autoritetet përkatëse, në mënyrë elektronike, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj;
- b) Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar.

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Dokumentacioni provues që OE i disponon punonjesit e mesipër do të dorëzohet nga **ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit**.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Autoriteti kontraktor në përcaktimin fuqisë punëtore të nevojshme për realizimin e kontratës është bazuar në llogaritjen e orëve të punës sipas manualit të çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”, Ligjin Nr. 7961, datë 12.7.1995 “KODI I PUNËS I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË“, i ndryshuar, grafikun e punimeve, zërat e punimeve të preventivit, volumet për keto zëra. **Duke e bazuar në këto komponente AK përcaktoi stafin kryesor teknik (inxhinieret), një numër minimal punonjësish të kualifikuar për çdo lloj punimesh dhe një numër minimal punonjësish të thejshme/ndihmes. Nga ky numër rezultoi se për të perfunduar brenda afatit dhe me sukses zbatimin e kontratës operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë minimalisht një numër prej 35 punonjësish (stafi kryesor teknik + punonjes të kualifikuar + punonjes të thejshme/ndihmes).**

2.3.7 Operatori ekonomik të ketë në stafin e tij:

- 1 (një) punonjes i pajisur me çertifikate “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”, (I ndryshuar).
- 2 (dy) punonjës/specialist të çertifikuar për “*Punime në lartësi*”, sipas VKM-së Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”, e dhënë nga një organizem i licencuar çertifikimi shqiptar ose i huaj.

Për punonjësin e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues që OE i disponon punonjesit e mesipërmdo të dorëzohet vetëm nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Këto kritere janë vendosur bauer në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të Ligjit 10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” si dhe të VKM Nr.312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Njësia e prokurimit gjykon se për mbarëvajtjen e punimeve, me qëllim garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen e shëndetit, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksident si dhe në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni sektorial në fuqi, është e nevojshme prezenca e ekspertit për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në kantierin e punimeve si dhe punonjesve të kualifikuar për punimet në lartësi. Në nenin 6 të ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë, i ndryshuar parashikohet:

”Detyrime të përgjithshme të punëdhënësve

1. Punëdhënësi, për sigurimin e mbrojtjes së punëmarrësve në të gjitha aspektet, që lidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë, merr masat e nevojshme nëpërmjet:

- a) parandalimit të rreziqeve për aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale;
- b) informimit dhe formimit profesional të punëmarrësve e të përfaqësuesve të tyre;
- c) organizimit të mbrojtjes kolektive dhe individuale;
- ç) sigurimit të organizimit të vendit të punës e të mjeteve të nevojshme.

2. Punëdhënësi kujdeset për përditësimin e masave të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duke marrë parasysh ndryshimet e rrethanave, për përmirësimin e situatave ekzistuese.

Në nenin 7 Shërbimet e mbrojtjes dhe të parandalimit, parashikohet:

1. Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarrës, që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë dhe të parandalimit të rreziqeve profesionale në ndërmarrje/institucion.

Në pikën 15 të V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”, ndër të tjera parashikohet:

15.1 Përkufizime

Në aplikimin e këtyre rregullave, kërkesave, me termat e mëposhtëm kuptojmë:

- a) pajisje pune është çdo makinë, aparat, instalim që përdoret në punë;
- b) përdorim i një pajisje pune: çdo operacion pune i lidhur me një pajisje pune në përdorim ose jo, transporti, riparimi, transformimi, mirëmbajtja, pastrimi, çmontimi;

c) zonë e rrezikshme: çdo zonë brenda ose në afërsi të një pajisje pune, në të cilën prania e një punëmarrësi përbën rrezik për shëndetin ose sigurinë e tij.

ç) **puna në lartësi: aktivitet pune e cila ekspozon punëmarrësin ndaj rrezikut të rënies nga një lartësi më e madhe se 2 metra, referuar një niveli të palëvizshëm.**

Numri i kërkuar është në proporcion me punimet e konsiderueshme që do të kryhen në lartësi dhe numrin e objekteve arsimore, gjithsej 18 të tilla të shpërndara në territorin e Bashkisë Elbasan (qytet dhe fshat).

2.3.8 Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në pajisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

Nr	Lloji i makinerive/pajisjeve/mjeteve	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës min 8-15 ton	Pronësi/Qira	copë	2
2	Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri 3.5 ton	Pronësi/Qira	cope	1
3	Makine me kosh	Pronësi/Qira	copë	1
4	Eskavator me zinxhir	Pronësi/Qira	copë	1
5	Autobetoniere	Pronësi/Qira	copë	1
6	Autopompe Betoni	Pronësi/Qira	copë	1
7	Nivelues Helikopter	Pronësi/Qira	copë	1
8	Minifadrome (mjet teknologjik)	Pronësi/Qira	copë	1
9	Minidamper	Pronësi/Qira	copë	1
10	Bombola gazi + llampa gazi	Pronësi/Qira	copë	2
11	Veshje pune zjarrduruese	Pronësi/Qira	copë	2
12	Betoniere	Pronësi/Qira	copë	2
13	Matrapik	Pronësi/Qira	copë	1
14	Tranxh hekuri	Pronësi/Qira	copë	1
15	Vibrator betoni	Pronësi/Qira	copë	1

16	Bot uji	Pronësi/Qira	copë	1
17	Gjenerator	Pronësi/Qira	copë	1

a) Për mjetet që regjistrohen ne regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, Çertifikaten e pronesisë, Çertifikatë për transport mallrash për llogari të vetë (vetem mjetet e transportit) dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumentet e mesiperme duhet të shoqerohen me kontratën noteriale perkatëse të qerave, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Për mjetet e transportit me qera të paraqitet gjithashtu Çertifikatë për transport mallrash për të trete dhe me qira. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të paraqiten aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Dokumentacioni provues, që OE i disponon mjetet e mësipërme, do të dorëzohet nga **ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit**.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç, 6/d dhe 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Gjithashtu kriteri është vendosur referuar zerave të punimeve.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar ne VKM Nr.216, date 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018).

Në mbështetje të dispozitës ligjore të sipërcituar Ligjvënësi i jep të drejtën Autoritetit Kontraktor të kërkojë nga ana e Operatorëve ekonomike **makinerite, mjetet dhe paisjet teknike**. Njësia e Prokurimit ka vlerësuar si të domosdoshëm paraqitjen e deklaratave dhe dokumentacionit përkatëse ne lidhje me mjetet dhe paisjet teknike që Operatori ekonomik disponon në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi.

Percaktimi i makinerive është bere referuar zërave të punimeve reflektuar ne tabelë sa më poshtë:

Nr	Lloji i Makinerive	Proceset sipas preventivit	Sasia
----	--------------------	----------------------------	-------

1	Eskavator me zinxhir	Germim dhe themele e plinta me b-2m, ekskavator me zinxhir 0.25m ³ , shkarkimi ne auto; Germim dhe me ekskavator 2.0 m ³ , ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria IV, me shk ne mjet.	copë 1
2	Minifadrome (mjet teknologjik)	Eshte kerkuar per shtytjen dhe largimin e mbeturinave qe krijohen nga germimet apo prishjet, sistemimin e ambientit. Eshte kerkuar minifadrome per shkak se punimet kryehen ne oborret e kopshteve dhe shkollave dhe hapësirat jane te ngushta.	copë 1
3	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes 8- 15 ton (AK ka vendosur te kerkoje 2 mjete te tille per te garantuar zbatimin me sukses te kontrates per shkak te numrit te konsiderueshme te objekteve arsimore si dhe shperndarjes gjeografike ne territorin e Bashkise Elbasan, qytet dhe fshat). Jane kerkuar 2 mjete me tonazh te tille per arsye se do te levizin brenda oborreve te kopshteve dhe shkollave ku nuk mund te levizin apo qendrojne mjete me tonazh me te madh per shkak te hapësirave.	Transport materiale ndertimi, dhe me auto deri 5.0 km Transport materiale ndertimi, dhe me auto deri 10.0 km Transport materiale si inerte, hekur, tulla, pllaka, tuba betoni, dyer dritare, konstruksione metalike etj	copë 2
4	Makine me kosh	Hidroizolim taracash, ngjitje punonjesish dhe materialesh, punime ulluqesh sipas zerave te preventivit	cope 1
5	Kamionçine me kapacitet mbajtes deri ne 3.5 ton Eshte kerkuar mjet me tonazh te tille per arsye se ne nje pjese te oborreve te kopshteve dhe shkollave nuk mund te levizin apo qendrojne mjete me tonazh me te madh pasi hapësirat jane te ngushta.	Per transportin ne kantier te materialeve te punes gjate gjithe kohes se zbatimit te kontrates.	copë 1
6	Autobetoniere	Prodhim dhe transport betoni per punimet e betonit dhe b/arme pjese e preventivit: Mur betoni C 16/20; Mur betoni C 20/25; Kollona b/a monolite C 16/20 h ~ 4m etj.	copë 1

7	Autopompe betoni	Hedhja e betonit ne mure, kollona etj sipas proceseve te punes pjese e preventivit: Mur betoni C 16/20; Mur betoni C 20/25; Kollona b/a monolite C 16/20 h ~ 4m etj.	copë 1
8	Nivelues Helikopter	Per ferkimin e siperfaqes se betonit	cope 1
9	Minidumper	Per levizjen e materialeve brenda kantierit	cope 1
10	Bot uji	Per furnizimin me uje te kantierit per procese te ndryshme gjate punes, lagjen e kantierit	copë 1
11	Tranxh hekuri	Per prerjen dhe kthimin e hekurit	cope 1
12	Vibrator betoni	Vibrim betoni sipas proceseve dhe markave te ndryshme pjese e preventivit	copë 1
13	Bombola gazi + llampa gaze	Mjete pune per shkrirjen e katramasa per hidroizolimet	copë 2
14	Veshje pune zjarr duruese	Pajisje mbrojtese per 2 hidroizolues	copë 2
15	Gjenerator	Furnizimin me energji te pajisjeve te ndryshme gjate proceseve te punes	copë 1
16	Matrapik	Per punimet e ndryshme te prishjeve pjese e preventivit	copë 1
17	Betoniere	Per prodhimin e llacit per punimet e suvatimit sipas preventivit	copë 2

2.3.9 Operatori/et ekonomike ofertues duhet të jetë i pajisur me licence nga Qendra Kombetare e Licensimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim, ruajtje dhe transportim i mbetjeve jo te rrezikshme” sipas kodeve 17 09 04 dhe 20 03 06 ose te kete kontrate sherbimi noteriale per objektin konkret me shoqeri te licensuara. Mbështetur në: Ligj Nr. 9010, date 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”(Ndryshuar me Ligjin Nr.10137, date 11.05.2009 “Per disa ndyshime ne legjislacionin ne fuqi per licensat, autorizimet dhe lejet ne Republiken e Shqiperise”) Kreu II N.9 N. 12 N. 24/1 N. 25.

Argumentimi: Kriteri per licencen e leshuar nga QKL me kodin III. 2. B eshte vendosur qe AK te kete sigurine qe operatori ekonomik qe do te ofertoje te jete i pajisur me certifikatat e mesiperme ose te kete kontrate sherbimi me subjekte te licencuara me licencen e lartepemundur, te lidhura me objektin e prokurimit, gje e cila krijon bindjen dhe sigurine te Autoriteti Kontraktor qe ky Operator Ekonomik i zoteron kapacitetet teknike per realizimin me sukses te kontrates.

Në seksionin “Kategoria III.2. “Shërbime Ekspertizë ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis”, nënseksioni “Licencimi i kategorisë III.2.B”, pika 8 dhe 9 të Vendimit nr.538 datë 26.05.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licensat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar parashikohet se:“ Licencat për nënkategorinë III.2.B jepet për çdo vend ku kryhet veprimtaria. 9. Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme.”

Për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit zotërojnë kapacitetin teknik e konkretisht licencë profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, ku të përfshihen ndër të tjera edhe transporti i mbetjeve të ngrurta, gjatë

kryerjes së veprimtarisë ose të këne këto kontrate shërbimi materiale për objektin konkret me shoqëri të licensuara si më sipër.

Sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se referuar Preventivit të Punimeve, autoriteti kontraktor ndër të tjera ka parashikuar kryerjen e punimeve prishje në taraca ku gjenerohen mbetje të klasifikimit 17 09 04 (Mbetje të perziera nga ndertimi dhe të prishjeve) dhe germime për riparimin e kanalizimeve dhe puseta të ujërave të zeza ku gjenerohen mbetje të klasifikimit 20 03 06 (Mbetje nga pastrimi i ujërave të zeza). Në nenin 5 të ligjit nr.10081 datë 23.02.2009 “Për Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet se “Ushtimi i veprimtarive dhe kryerja e veprimeve në territorin e Republikës së Shqipërisë janë, si rregull, të lira dhe nuk i nënshtrohen licencimit apo autorizimit, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj.” Sa më sipër konstatohet se gjatë kryerjes së punimeve, referuar edhe parashikimeve të preventivit, shfaqet ndër të tjera kryerja e veprimtarisë transporti i mbejtëve inerte i cili referuar kuadrin ligjor në fuqi duhet të kryhet nga subjekte të licensuara dhe është në përputhje me natyrën dhe vëllimin e kontratës.

2.3.10 Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme:

- SSH/EN-ISO 9001 (*Sistemi i menaxhimit të cilësisë*) ose ekuivalent
- SSH/EN-ISO 14001 (*Sistemi i menaxhimit të mjedisit*) ose ekuivalent
- SSH/EN-ISO 45001 (*Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë*) ose ekuivalent

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i këtij bashkimi duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes).

Argumentimi: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sa më sipër janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”. ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në

mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtare, i cili parashton kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

2.3.11 Operatori Ekonomik ofertues duhet te paraqesë:

Per materialet leter katrama, polisterol kompakt, dritare dhe dyer d/alumini dhe boje hidroplastike në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontrate noteriale furnizimi me prodhuesin/t ose distributorin/ët zyrtare te tyre per furnizimin me materialet e mesiperme gjate zbatimit te kontrates, Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve, ku të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të perdoren dhe të jenë paraqitur dhe markuar të dhënat teknike për mallrat objekt prokurimi.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 2 dhe pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë dhe te garantojne autoritetin kontraktor që materialet qe do te perdoren për realizimin e punimeve të kontratës do te jene ne perputhje me kerkesat dhe cilesine e shprehur ne specifikimet teknike. Materialet e siperciatuara jane te lidhur ngushte me zerat e preventivit, secili prej tyre ka nje peshe specifike te konsiderueshme ne volumet e punes dhe te gjithë bashke perbejne pjesen themelore te kontrates.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet Teknike per proceduren respektive jane hartuar nga drejtoria e projekteve, pjese perberese e struktures se Bashkise Elbasan, qe ka hartuar edhe projektin perkates te zbatimit duke gene elemente perberes te tij. Ne hartimin e tyre jane marre ne konsiderat kerkesat ligjore te fushes se planifikimit dhe zhvillimit te territorit si dhe normat perkatese te Ligjit nr. 9290 , date 7.10.2004 “Për produktet e ndërtimit” i ndryshuar dhe Vendim i KM nr.312, datë 5.5.2010 Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” si dhe kerkesat e ligjit te Ligjit Nr. 10480 datë 17.11.2011 , "Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore".

Specifikimet Teknike jane pjese e setit te dokumentave te ngarkuara ne SPE per proceduren respektive.

Fondi Limit i perlogaritur per kete procedure eshte hartuar ne baze te VKM nr 629 date 15.07.2015 ''Per Miratimin e Manualeve Teknike te Cmimeve te Ndertimit dhe analizat teknike te tyre'',

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do

*të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.